



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/03-34129 dt. 23.07.2021

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 30. 07. 2021 (e Premte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i dt. 29.06.2021.
2. Informim i kuvendit për aktivitetet e KKSBB-së.
3. Raporti financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar- Qershor 2021.
4. Bartja e mjeteve nga Rezerva Buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave.
5. Propozim vendim i komisionit për emërim të rrugëve.
6. Të ndryshme.

Drenas, 23.07.2021

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 23.07.2021, si vijon:

Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K.P.F-ca për rendin e ditës, fjalën e mori kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci ku shtoi edhe dy pika shtesë për rendin e ditës:

- 1. Bartja e mjeteve nga Rezerva Buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave.**
- 2. Propozim vendim i komisionit për emërim të rrugëve.**

Të gjithë anëtarët e KPF-ca u pajtuan me këtë rend dite, dhe e votuan në mënyrë anonime, edhe me këto dy pika shtesë që i ceki kryetari me lartë.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt.

18.06.2021. Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime u kalua ne mënyre unanime, me 5 vota për, 00 abstenim dhe 00 kundër.

2. Informim i kuvendit për aktivitetet e KKSB-së.

Pas sqarimit të drejtorit nuk pati diskutime dhe u votua ne mënyrë anonime për kuvend.

3. Raporti financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar- Qershor 2021.

Rekomandohet për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës pas sqarimit te drejtorit.

4. Bartja e mjeteve nga Rezerva Buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave.

U aprovua në mënyrë anonime.

5. Propozim vendim i komisionit për emërim të rrugëve.

U votua në mënyrë anonime nga të gjithë anëtarët e KPF-ca dhe nuk pati diskutime tjera.

6. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime.

Mbledhja përfundoj rreth orës 10:55 min.


Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 06061-33608 dt. 22/07/ 2021

Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
29.06.2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 29.06.2021

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 28 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i dt. 31.05.2021
2. Propozim Vendim i pikës 17,të nenit 1, të Vendimit nr. 12-360-68569, të dt. 29.11.2019,të Kuvendit Komunal të Drenasit.
3. Draft -Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024.
4. Propozim Vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit i plotësuar.
5. Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2, të Vendimit nr. 12-360/02-9351, të dt. 26. 02. 2021 të Kuvendit Komunal të Drenasit, i plotësuar.
6. Njoftim lidhur me shkresën për koston e Kontratave Kolektive.
7. Propozim vendim për ndarjen e subvencioneve për njëmbëdhjetë (11) bursave për nxënësit e SHML "GJ. K. Skënderbeu" në Drenas.
8. Propozim vendim për shqyrtimin publik të Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2021-2029.
9. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 12-030-13435,të dt. 26.03.2021, për miratimin e statutit të QKMF-se Dr. "Hafir Shala" e plotësuar.
10. Të ndryshme.



Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 29.06.2021 ishin: Kryesuesi Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nënkryetari i Komunës Arben Shala, drejtorët e drejtorive komunale, shefi i kabinetit të kryetarit Flamur Curri.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, hapi mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal te dt. 29.06.2021

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, pasi përshëndeti të gjithë theksoj se kemi me e shti edhe një pikë të rendit të ditës: propozim vendim për bartjen e mjeteve për bartjen e mjeteve për shlyerjen e borxheve tatimore të NP "Kovova Trans" Gllogoc, e cila ka ardhë një borxh i vjetër të cilin duhet urgjent me e pagu, ne rast se e kalojmë sot në kuvend ne si pas gjitha informacioneve nuk i humbim 9.000 euro, ju ftoj me e votu si propozim vendim, borgj i 2003-2012 komuna që nuk i ka pagu pasi e kemi pranë një shkresë nga administrata tatimore e Kosovës departamenti për menaxhimin për mbledhjen e borxheve të grumbulluara prej viti 2003 deri ne vitin 2012 komuna nuk i ka pagu këto taksa, ky vendim nuk shkon për ligjshmëri nëse e votojmë atëherë sot mundemi me e ekzekutu, pra i keni 10 pika për rendin e ditës.

Pasi qe nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, me këto pika:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i dt. 31.05.2021
2. Propozim Vendim i pikës 17,të nenit 1, të Vendimit nr. 12-360-68569, të dt. 29.11.2019,të Kuvendit Komunal të Drenasit.
3. Draft -Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024.
4. Propozim Vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit i plotësuar.
5. Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2, të Vendimit nr. 12-360/02-9351, të dt. 26. 02. 2021 të Kuvendit Komunal të Drenasit, i plotësuar.
6. Njoftim lidhur me shkresën për koston e Kontratave Kolektive.
7. Propozim vendim për ndarjen e subvencioneve për njëmbëdhjetë (11) bursave për nxënësit e SHML "GJ. K. Skënderbeu" në Drenas.
8. Propozim vendim për shqyrtimin publik të Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit për periudhën 2021-2029.
9. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 12-030-13435,të dt. 26.03.2021, për miratimin e statutit të QKMF-se Dr. "Hafir Shala" e plotësuar.
10. Propozim vendim për bartjen e mjeteve për bartjen e mjeteve për shlyerjen e borxheve tatimore të NP "Kovova Trans" Gllogoc
11. Të ndryshme.

Prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me: 26 e votuan për, 02 abstenim, 00 kundër.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë te rendit të ditës:
1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i dt. 31.05.2021

Pasi qe nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës ku prezent ishin 28 anëtar dhe votuan me: 28 e votuan për, 00 abstenim, 00 kundër.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:
2.Propozim Vendim i pikës 17,të nenit 1, të Vendimit nr. 12-360-68569, të dt. 29.11.2019,të Kuvendit Komunal të Drenasit.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë piktë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit janë 28 anëtar ku votuan me:
28 vota për, 00 vota kundër, 00 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:
3.Draft -Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë piktë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit janë 28 anëtar ku votuan me:
27 vota për, 00 vota kundër, 01 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:
4.Propozim Vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit i plotësuar

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Mapl-ja na ka kthyer në rishqyrtim sepse u dashtë me e fut edhe emrin e zyrtarit të ministrisë së arsimit, na nuk mundemi me e fut emrin sepse ata e caktojnë.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë piktë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit janë 28 anëtar ku votuan me:
28 vota për, 00 vota kundër, 00 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:
5.Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2, të Vendimit nr. 12-360/02-9351, të dt. 26. 02.2021 të Kuvendit Komunal të Drenasit, i plotësuar.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë piktë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit janë 28 anëtar ku votuan me:
28 vota për, 00 vota kundër, 00 abstenim

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:
6.Njoftim lidhur me shkresën për koston e Kontratave Kolektive.

Sabrije Kukaj, a janë kontratat kolektive që kanë të bëjnë lidhur me arsimin dhe shëndetësinë, mirë që po sqarohet kjo punë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nuk ka komunë që i ka pagu, ka komuna që e kanë paguar pjesërisht e kanë përdor fondin për rezerva ne nuk e kemi përdor për arsyeje se nuk kemi dashtë me bo shkelje ligjore. Kontratat e lidhura ne mes ministrive të linjës edhe sindikatave të pavarura e kanë për obligim dhe detyrim që ato kontrata ta miratojnë edhe buxhetin në kuvendin

e Kosovës për atë qëllim për implementim, nuk e kanë miratuar, nuk kemi buxhet të ndarë për këtë çështje na merr me përmbarues, na i kemi borxh prej majit 2017 deri në dhjetor 2021 i kemi 4.063.131.20 € në sektorin e arsimit ndërsa në shëndetësi i kemi 708.141.50 € totalin e kemi 5,822,476,34 €, ne e kemi sjelle si një ofitim sepse kjo është përgjegjësi e ministrisë.

Nexhmedin Balaj, është mirë me u sqaruar është një shkresë drejtuar ministrisë së financave dhe ministrisë së arsimit dhe ministrisë së shëndetësisë, mësuesja e cekit shumë mirë shujta, udhëtimi shtesat e gradimit në kuadër të ministrisë së shëndetësisë janë orët shtesë të cilët i mbajnë, kujdestaritë, festat, tri pagat përcjellëse, paga e 13, paga jubilarë, të gjitha këto rrjedhin si pasoje e kontratave të nënshkruara të vitit 2017 dhe zotimet e atëhershme të qeverisë dhe të ministrisë e që kanë shkruar në detyrë të komunave, unë mendoj se kjo shkresë është shumë e qëlluar por është pak e vonuar.

Meqë nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit janë 26 anëtarë ku votuan me:
26 vota për, 00 vota kundër, 00 abstenim

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për ndarjen e subvencioneve për njëmbëdhjetë (11) bursave për nxënësit e SHML "GJ. K. Skënderbeu" në Drenas.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit janë 26 anëtarë ku votuan me:
26 vota për, 00 vota kundër, 00 abstenim

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim vendim për shqyrtimin publik të Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2021-2029**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit janë 26 anëtarë ku votuan me:
26 vota për, 00 vota kundër, 00 abstenim

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 12-030-13435, të dt. 26.03.2021, për miratimin e statutit të QKMF-se Dr. "Hafir Shala" e plotësuar.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit janë 26 anëtarë ku votuan me:
26 vota për, 00 vota kundër, 00 abstenim

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. propozim vendim për bartjen e mjeteve për bartjen e mjeteve për shlyerjen e borxheve tatimore të NP "Kovova Trans" Glllogoc**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit janë 26 anëtar ku votuan me:
26 vota për, 00 vota kundër, 00 abstenim

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11.Të ndryshme.**

Sokol Bylykbashi, përshëndeti të gjithë të pranishmi, ka ankesa por edhe shqetësime nga qytetaret, po filloj nga fshati Kishnarekë ka ankesa që mësimdhënësit janë duke pirë alkool në shkollë, nuk e di sa është e vërtetë mirëpo kemi ankesa nga qytetaret, është mirë me u marrë organet kompetente për çështje, dhe ka ankesa që dy shitore që janë aty afër po ju shesin duhan fëmijëve është mirë inspeksioni me e verifiku këtë çështje, tjetër kërkesë kemi nga përfaqësuesit e familjarëve të Poklekut të Ri bëhet fjalë për një ngjarje që ka ndodh rrëmbimi i 10 personave e cila është një pllakë perkujtimore në Poklek edhe pllakë e cila nuk është nen menaxhimit e agjencisë, është mirë kryetari me autoritetin që ka me bërë kërkesë në agjencinë përkatëse në mënyrë që me qenë në menaxhim të saj, kërkesa tjetër ka te beje me një ish punëtor të komunës Xhevat Heta i cili kam informacione që nga muaji mars kërkon për një subvencionim që ka te beje me një tretman shëndetësor dhe nuk iu kane dhënë ende dhe do të ishte mirë që si komunë me i ndihmu në këtë drejtim, ankesa tjetër është një punëtor i zjarrfikëseve me ka thënë që nëse ndodhin dy fatkeqësi në dy vende të ndryshme nuk kish kapacitet me i bërë dy intervenime në të njëjtën kohë, kjo është shumë shqetësuese, do të ishte mirë me u marrë edhe me këtë çështje sepse është shumë shqetësues dhe duhet me e bërë një zgjidhje urgjente, dhe një shqetësim tjetër me ngritjen e temperaturave rritet mundësia edhe për helmim nga gastronomia, jam duke dëgjuar se ka raste të helmimeve në Drenas dhe nuk po denoncohen por kërkoj nga inspektorati që me pas kontrole të rrepta aty ku ka raste, këto janë kërkesat të cilat me shqetësojnë.

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci, komuna e ka një faqe zyrtare ku shqetësimet e qytetareve duhet me ardh zyrtarisht dhe gjithçka regjistrohet, në shkollë të Kishnarekes janë kamera dhe kushdo mundet me e verifiku, dhe kjo është një e pavërtete për mua derisa thuhet pa emër dhe mbiemër çdo gjë që nuk ka adresim të saktë për mua është e pavërtete, shitja e duhanit mësuesja është e vetmja që ka kërkuar që shitoret mos me qenë afër shkollave, mirëpo për fat të keq kemi, duhan nuk ka te drejt askush me iu shit fëmijëve jo vetëm shitore të shkolla mirëpo në asnjë shkollë sepse edhe diçka që edhe e ndaluar me ligj. Pllaka në Poklek të Ri unë i kam bërë kërkesë agjencinë dhe për rregullimin e varrezave në fshatin Terstenik mirëpo na kanë thënë që nuk kemi mjete për këtë vit, por ne nuk kemi mjete për këto qëllime dhe nuk i kemi në përgjegjësi mirëmbajtjen e tyre dhe ne mund të bëjmë se çka të është e nevojshme, ju e dini se shtatoret i kemi bërë me mjete të miqve tanë me donacione në përjashtim të shtatores të Hafir Shalës, për Xhevat Heten i kam dhënë mjete edhe nga fondi jem dhe është në komision kërkesa e tij është ministria e shëndetësisë e cila ndan mjete, ne i kemi ndihmua e kemi liruar 2 vjet ma herët në pension të parakohshëm i cili e merr pagën 70 % ma shumë nuk mundemi me bërë, kam respekt për të, sa i përket shqetësimit për zjarrfikës unë se pari para 3 viteve e kom pas shumë vështirë me ia ngrit se paku gjysme koeficienti janë 4 zjarrfikës në ndërrim edhe me pas nevojë me intervenua dy vena nuk mundën me intervenua, Amea është përgjegjëse për këtë çështje. Vetëm një inspektor sanitar e kemi, një të ambientit një të komunikacionit, ne jemi duke u munduar me këtë kapacitete që e kemi me ju ofruar shërbime sa me të mira qytetareve .

Sokol Bylykbashi, mendoj qe nuk po e teprojmë mirëpo shqetësimet që i kemi ne duhet me i adresu këto ankesa diku, kjo është puna kryesore, sa i përket problemeve ne teren është mirë me i verifiku.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, unë e thash që adresimi pa emër është mashtrim dhe nuk pranoi mashtrime dhe për derisa nuk ke dështimi nuk e ndjek askënd.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, pati një njoftim, dje kemi pranuar një informim dy drejtime janë larguar nga shkolla është e pakuptimte sepse ne e kemi dërguar planifikimin, pasi kemi pranuar dokumentet për këto drejtime na kanë informuar se nuk i kemi këto dy drejtime. Edhe ka qene shqetësim se nxënësit vetëm 3 dit kane pas afat për regjistrim, nuk ka pas arsytim, shkresën e kemi përcjell dje sekretares se ministrisë, nuk kemi marr ende ndonjë përgjigje. Këto dy profile ne shkollën e mesme ekzistojnë prej vitit 2017-2018, kemi kërkesa jashtëzakonisht te mëdha, ankesa qytetaret, nxënësit nuk e kuptojnë dhe na fajësojnë neve si drejtori e arsimit qe nuk i kemi marr masat, mirëpo ne si drejtori e kemi bërë një ankesë sa i përket kësaj çështje, ne kemi edhe kuadër te angazhuar me kontratë është kundërligjorë dhe ndikon jashtëzakonisht keq, ne e kemi dërguar si shqetësim apo ankese tonën se ditën kur ka fillua regjistrimi me na njoftua, prandaj deshta me ju njoftu, si dhe afati për regjistrim të nxënësve në shkollë të mesme ka qenë vetëm 3 ditë ka qenë afat shumë i shkurtër, por sipas të gjitha parashikimeve në këto dy drejtime nuk do të lejohet të pranohen nxënës të rinjë për ketë vit.

11:40 min

Procesmbajtëse:

Liridona Fejza-Ajazi

Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Labinot Halilaj

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		16 / 07 / 2021	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
12	030/01-	32767	



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

Drenas, me 16.07.2021



Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKSB-së

Sipas udhëzimit administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat komunale për Siguri në Bashkësi, neni 9 Detyrat dhe Përgjegjësitë e kryesuesi të KKSB-së, pika 1.8 është e obliguar të bëhet informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e KKSB-së.

Duke u bazuar në këtë udhëzim, ju informoj se në fillim të vitit 2021 me qëllim të realizimit të detyrave operative lidhur me çështjet e Sigurisë në Bashkësi, në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr.04/01-076, për Policinë, neni 11, pika 2 e udhëzimit administrative nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për KKSB-në, është caktuar orari i punës, ku janë paraparë gjashtë (6) takime të rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, plan ky i cili është miratuar në fillim të vitit fiskal në mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Gjatë kësaj periudhe, deri në këtë ditë ku po raportojmë, janë mbajtur 3 takime, përkatësisht me datë 05 shkurt, 14 prill dhe 29 qershor 2021. Në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me sigurinë në bashkësi në Komunën e Drenasit, si Siguria Fizike, Siguria e Ambientit, Siguria Shëndetësore, Siguria Rrugore, Siguria Institucionale dhe propozime të tjera.

Në mbledhje janë ftuar anëtarët e KKSB-së dhe monitorues, ku sipas afateve ligjore, përkatësisht 7 ditë para mbajtjes së takimit është dërguar ftesa bashkë me pikat e rendit të ditës.

Në mbledhjen e parë të mbajtur me 05 shkurt, janë diskutuar këto pika:

1. Draft plani i punës së KKSB-së për punën e vitit 2021;
2. Draft orari i punës së KKSB-së për vitin 2021;
3. Njoftim lidhur me menaxhimin e vërshimeve të fundit;
4. Përgatitjet nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve-KKZ në Drenas për zgjedhjet parlamentare;
5. Informim lidhur me fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2021/2021;
6. Trajtimi i qenve endacak;
7. Funkcionalizimi i kamerave në Komoran dhe vendosja e kamerave në Komoran 3

Lidhur me këto tema, anëtarët e KKSBB-së kanë paraqitur kërkesat e tyre, ku për secilën pikë janë përgjigjur zyrtarët përkatës sipas natyrës së kërkesave.

Mbledhja e dytë është mbajtur me datë 14 prill ku janë diskutuar temat si në vijim:

1. Njoftim për situatën epidemiologjike në Komunën e Drenasit dhe vaksinimi i stafit shëndetësor;
2. Informim lidhur me masat e reja kufizuese dhe përgatitjet për mësimin në distancë;
3. Diskutim për qentë endacak


Po ashtu, gjatë kësaj mbledhje është diskutuar edhe për mbajtjen e mësimin online gjatë pandemisë, përkatësisht problemet e kyçjes në mësimin online e tjera çështje.

Ndërsa, mbledhja e tretë është mbajtur me datë 29 qershor, ku janë diskutuar gjashtë (6) pika si:

1. Njoftim për situatën epidemiologjike dhe vaksinimin në masë;
2. Njoftim lidhur me mbarimin e vitit shkollor 2020/2021;
3. Njoftim lidhur me çështjen e ndriçimit publik dhe mirëmbajtjen e tij;
4. Masat e ndërmarra për sigurimin e ujit të pijes gjatë sezonës së verës;
5. Ndërmarrja e masave parandaluese për zjarrvëniet në natyrë

Ndërsa, të të ndryshmet është diskutuar siguria në trafik, përkatësisht angazhimin e stacionit policor në Drenas për sigurinë në trafik. Për këto mbledhje janë mbajtur procesverbale nga koordinatori i KKSBB-së, janë protokolluar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës së Drenasit. I njëjti është përcjellur edhe për në Ministrinë e Pushtetit Lokal (MAPL).

Përveç KKSBB-së janë mbajtur Këshillat Lokal për Sigurinë Publike ashtu siç parashihet me udhëzim administrativ, gjithsej 5 takime të kryesuara nga kryesuesi i KLSP-së. Në këto takime janë diskutuar tema që lidhen me sigurinë, të cilat mëpastaj janë adresuar në mbledhje të KKSBB-së.

**Kryetari i Komunës**
Ramiz Lladrovci


REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC

Nr. 400/01-3/2026

Më
On. 09/07/2021



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT



RAPORTI FINANCIAR

I Zhvillimit Të Buxhetit Janar - Qershor 2021

KORRIK 2021

Baza për Raportim

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP-së) përkatësisht nëni 45.4, kryetari i komunës duhet të dorëzojë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte periodike të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të vitit .

Raportet duhet t'i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo periode, dhe të publikohen në faqen e internetit të komunës.

Kryetari i Ligjit raportit është që të njoftoi Bordin e Drejtorve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendin Komunal, të gjitha mediet (elektronike dhe të shtypit) si dhe qytetarët për realizimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese janar-qershor 2021.

Kryetari Komunal për periudhën janar-Qershor 2021 nënkupton Ligjin .07/L-041 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Deri sa buxheti paraqet qëllim-performancës, raporti paraqet masën deri në të cilën qëllimet e performancës janë arritë, duke përfshi vlerësimin kuantitativ dhe kualitativ të rezultateve. Ky raport gjithashtu paraqet edhe krahasime me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Në këtë raport paraqitet mënyra dhe mënyrat të buxhetit për nga karakteri ekonomik në pesë kategori kryesore ekonomike të shpënzimit; ndërsa për nga karakteri funksional në tërësi (20 programe -nënprograme buxhetore.

Kryetari i raportit për shpenzimet operative (Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime të Shërbimeve Komunale dhe Subvencio) shpenzime të Investimeve Kapitale, janë në harmoni me Departamentin e Thesarit pranë Ministrisë për Financa Punës dhe Transfereve, ndërsa të tjerat për numrin e punëtorve dhe shumat për shpenzimet e Pagave dhe Mëditjeve me Shërbimin e përllogaritjes së pagave në Ministrinë e Administratës lokale.

Struktura e raportit është bërë në pajtim me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë 03/L-048, të ndryshuar me Ligjin 04/L-048 dhe Standartet Ndërkombtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) bazuar në para të gatshme-raportimi financiar sipas parimit kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Kryetari i raportit është bërë në bashku me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa është munduar me përkushtimin më të madh të stafit dhe stafit të paraqes realizimin-zhvillimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese, gjegjësisht janar-Qershor/021. Kështu raporti është Euro (€).

Kryetari i raportit është bërë në bashku me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa është munduar me përkushtimin më të madh të stafit dhe stafit të paraqes realizimin-zhvillimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese, gjegjësisht janar-Qershor/021. Kështu raporti është Euro (€).

Kryetari i raportit është bërë në bashku me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa është munduar me përkushtimin më të madh të stafit dhe stafit të paraqes realizimin-zhvillimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese, gjegjësisht janar-Qershor/021. Kështu raporti është Euro (€).

Tabela 1

Përshkrimi	Buxheti	Pagat	Mallra e sherb.	Shpenz. Kom.	Subv. e transf.	In. Kapitale	Nr l puntorve
Starti	292,170.00	156,956.00	129,214.00	-	6,000.00	-	19
Personi	537,155.00	235,055.00	139,100.00			163,000.00	42
Shërbimi	109,844.00	72,329.00	37,515.00				11
Shërbimi	147,965.00	109,465.00	38,500.00				
Shërbimi dhe finan.	122,265.00	103,865.00	18,400.00				16
Pub. Ent.	781,959.00	173,363.00	282,596.00	90,000.00	90,000.00	146,000.00	25
Pub. Ent. Publi	2,409,140.00	47,801.00	25,750.00			2,335,589.00	8
Publi	8,673.00	7,983.00	690.00				1
Publi	128,957.00	73,217.00	11,740.00		44,000.00		13
Publi dhe Zhvill. E	94,539.00	48,789.00	25,750.00		20,000.00		8
Publi dhe I ad.	493,990.00	83,440.00	10,550.00			400,000.00	13
Publi	106,796.00	48,379.00	18,417.00			40,000.00	8
Publi	114,175.00	36,837.00	52,338.00		25,000.00		5
Publi Shënd	2,084,614.00	1,300,143.00	352,614.00	48,000.00		383,857.00	181
Publi Sociale	115,043.00	92,379.00	16,713.00	5,951.00			14
Publi dhe sporti	475,767.00	76,318.00	49,449.00		105,000.00	245,000.00	13
Publi	866,478.00	76,212.00	315,266.00		80,000.00	395,000.00	12
Publi	171,217.00	118,615.00	46,482.00	6,120.00			22
Publi	4,931,473.00	4,548,372.00	321,789.00	61,312.00			739
Publi	1,407,114.00	1,290,482.00	95,507.00	21,125.00			175
Publi	15,399,334.00	8,700,000.00	1,988,380.00	232,508.00	370,000.00	4,108,446.00	1,325

1. Tabela e lartë shënuar paraqet buxhetin-planifikimin e të hyrave dhe të dalave-shpenzimeve, tabelat në vazhdim të raportit paraqet planifikimin e buxhetit, po ashtu për të hyra dhe të dalat për periudhën raportuese.

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar - Qershor 2021 dhe krahasimi i tyre me një vit më parë.

Tab. nr.2

Red.	Muaji	Palni 2021	Realizimi 2021	Real.Vitit 2020	% me plan	Krahasimi me 2020%
1	Janar	108,888.33	108,195.73	98,915.00	99.36	109.38
2	Shkurt	108,888.33	70,062.74	102,622.35	64.34	68.27
3	Mars	108,888.33	87,324.29	48,700.69	80.20	179.31
4	Prill	108,888.33	75,257.20	15,706.41	69.11	479.15
5	Maj	108,888.33	102,975.21	30,286.37	94.57	340.01
6	Qershor	108,888.33	123,918.28	104,193.43	113.80	118.93
	Totali	653,329.98	567,733.45	400,424.25	86.90	141.78


Fig. 1. Shënime nga raporti i free balance të datës 02.04.2021 pa gjoba trafiku dhe gjykatav.

Fig. 1. bota Nr. 2, paraqet të dhënat lidhur me arkëtimin e të hyrave nga burimet vetanake për periudhën janar-Qershor të vitit fiskal 2021, të krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Krahasuar me planifikimin (1,306,660.00 €) të hyrat nga burimet vetanake janë realizuar 86.90%, ndërsa në raport me periudhën e njëjtë të një vitit më parë kemi ngritje të performancës për 41.78%, ne këtë raport nuk janë marrë në hyrat indirekte nga gjykatat dhe gjobat e komunikacionit dhe grantet e performancës.

Arkëtimin tuaj gjobat nga komunikacioni janë në shumë prej: 105,248.30 euro ,ndërsa nga grantet e donatorve atyre të brendshëm shuma prej 1,200,051.35 pa gjoba te komunikacionit , nese ja shtojm dhe atë shumë kemi të realizuar shumën prej:1,200,051.35

Paraqitja grafike e planifikimit të të hyrave dhe realizimit për periudhën Janar - Qershor të vitit 2021.

Chart Title



[illegible]

7.6. Raporti i Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar tregojnë se ndarjet nga Grantet janë Qershor paraqesin shumën prej:

[illegible]

...ajut Oeveritare (Burimi I financimit 10) = 8,977,840.98 €,

3. **Arvuti nga 3 urime Vetanake 2021** (Burimi i financimit 21) = 549,063.47 €, të alokuara

2020 (Burimi i financimit 22) = 775.859.86 €, dhe

Finanțare (durin) financim 31) = 11.852.85 €.

...le performance (59-61) = 520,672.51 €

Preț chirie: 47.913,00 €

Githset pranimet	10,883,202.70
------------------	---------------

Shënim i detyrueshëm: Komunal për periudhën Janar-Qershor 2021 lidhur me të dalat-shpenzimet

© 2007 Banka shpërndarë e të drejtave të autorit Bankar I Kosovës
Të gjitha të drejtat rezervohen. Nr. 10006500700000022.

Në vijim kemi edhe këto ndarje teknike - koncepte kryesore:

konstruktion, krahas përgjegjësisë. Në vijim kemi edhe këto ndarje teknike - koncepte kryesore:

- Andaria buxhetore,
- Alodimi I fondeve,
- Ezimi I fondeve,
- burimi I-penzimeve,
- Produrimi,

Pranimi i mallërave - shërbimeve ,
Pagesa e faturave dhe
fëshimi i fondeve nga llogaria bankare.

Është arritur qëllimet e një performance sa më të mirë në drejtim të shfrytëzimit të parasë publike (Vlera për paranë) me kohë në janar të vitit të ardhshëm të përgatitur Planit i zotimit dhe shpenzimit të parasë së gashme sipas periodeve të vitit 2021 dhe është dorëzuar në Departamentin e Thesarit-M.F.P.T si para kushtë i ndarjes së mjeteve. Për këtë periudhë mjetet financiare janë akorduar sipas planit , Pagat dhe Mëditjet e dyndbëhjeta e buxhetit për muaj; ndërsa për kategorit tjera ekonomike të shpenzimeve sipas planit.

Shërbat vijuse është bërë paraqitja e zhvillimit të buxhetit si për nga karakteri ekonomik, e poashtu edhe funksional i planifikimit dhe

konkludim.

Shënim - shpenzimi i buxhetit komunal sipas Programëve-nënprogrameve për periudhën Janar -Qershor 2021

2.1 Kryetari

Tab.3

